



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 118, datë 06.06.2019

**PËR
MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE NDAJ BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23 dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me kërkesat e neneve 2 dhe 19 të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me Ligjin nr.54/2014, datë 29.05.2014 dhe të nenit 42, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, ka kryer inspektim në Byronë Shqiptare të Sigurimit në datat 6 dhe 7 maj 2019, në zbatim të shkresës nr. 1068/7, datë 25.04.2019.

Me shkresën nr. 1068/16, datë 09.05.2019, projekt raporti Ju dërgua BSHS-së, e cila me shkresën nr. 3201 prot., datë 15.05.2019, ka depozituar observacione mbi projekt raportin e inspektimit. Gjetjet kryesore të këtij inspektimi lidhen kryesisht me zbatimin e afateve të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012, për shpërndarjen të shoqëritë e sigurimit të praktikave të përfunduara. Pas shqyrtimit të observacioneve të dërguara nga BSHS, grupi i inspektimit vlerëson se observacionet nuk qëndrojnë përse i përket zbatimit të afateve në Rregulloren nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, e ndryshuar,

Gjithashtu, Byroja në raportimin periodik që harton në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, nuk ka të pasqyruar saktë detyrimin e Fondit të Kompensimit, si dhe pagesat e kryera nga shoqëritë e sigurimit.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, referuar situatës së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, lidhur me performancën e saj dhe domosdoshmërinë për ndjekjen e problemeve që lidhen me Fondin e Kompensimit,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit:
 - 1.1 Të kryejë deri më datë 17 qershor 2019, shpërndarjen e praktikave të përfunduara, të detyrueshme për tu ekzekutuar, te shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së;
 - 1.2 Të kryejë shpërndarjen e çdo praktike të përfunduar, te shoqëritë e sigurimit sipas afateve të përcaktuara në pikën 4, të nenit 6, të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, e ndryshuar;
 - 1.3 Të hartojë formularët e raportimit periodik, në zbatim të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, duke pasqyruar saktë detyrimin e Fondit të Kompensimit, si dhe pagesat e kryera nga shoqëritë e sigurimit;
 - 1.4 Të rishikojë nevojën për shtesë të Fondit të Kompensimit, duke marrë në konsideratë çdo vendim që do të merret i formës së prerë.
2. Byroja Shqiptare e Sigurimit të depozitojë informacion mbi zbatimin e kërkesave të mësipërme deri më 10 korrik 2019.
3. Në rast të moszbatimit të kërkesave të mësipërme, Autoriteti do të vijojë me përshkallëzim të masave administrative.
4. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI